



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8287 /2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 73, Udhëzimin Administrativ 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit nr.01/7703 – 2018 , neni 41, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2019 merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për themelimin e Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuar në komunën e Hanit të Elezit.
2. Komiteti konsultativ për personat me aftësi të kufizuar përbëhet prej 5 anëtarëve, përbërja e të cilit do të jetë nga qytetarët dhe organizatat joqeveritare.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

Kryetari i Komunës,
Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26. 09. 2019



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



01/Nr.8286/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , 73, Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna neni 8, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 41, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2019 merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PUBLIK PËR KOMITETIN KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE ÇAKTIMIN E KRITEREVE

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për shpalljen e konkursit publik për Komitetin Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar në komunën e Hanit të Elezit dhe çaktimin e kriterëve.
 - Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuara, pesë (5) anëtarë.
2. Kriteret:
 - Anëtarët e Komiteteve konsultative përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët duhet të jenë njohës të fushave përkatëse .
 - Përfaqësimi gjinor në Komitetet Konsultative duhet të jetë sipas legjislacionit në fuqi.
 - Kandidatët për anëtar në Komitetet Konsultative duhet të jenë banor të Komunës së Hanit të Elezit.
 - Përgatitja profesionale është përparësi.

Dokumentet e kërkuara: CV, Diploma, Certifikata e lindjes, Kopje e letërnjoftimit, Certifikata e vendbanimit.

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë do t'i nënshtrohen intervistimit.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetën publike.

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas kësaj date nuk do të shqyrtohen .

Mandati: Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është katër (4) vjeçar. Anëtarët e Komiteteve Konsultative nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të atyre komiteteve.

Kompensimi: Për punën e tyre në Komitetet Konsultative, anëtarët e këtyre komiteteve do të kompensohen në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

3. Kompetencat e Komiteteve Konsultative:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme,
 - Paraqesin propozime për hulumtime të ndryshme.
 - Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushat përkatëse.
 - Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
 - Japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

Kryetari i Komunës,
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26.09.2019





01/ Nr.8233/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2019 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së kuvendit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2020.
2. Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit për vitin 2020 planifikon t'i mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e komitetit për politik dhe financa.
3. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hani të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

Vendimet/Çështjet

	Vendimet/Çështjet
JANAR 2020	<ul style="list-style-type: none">• Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.• Plani i punës së tri komiteve konsultative për vitin 2020.• Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2020.• Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2020.• Shqyrtimi i informatës mbi veprimtarit afariste.• Propozim vendimi për ndarje e bursave për student.
SHKURT 2020	<ul style="list-style-type: none">• Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për vitin 2019.• Raporti i shpenzimeve buxhetore për vitin 2019.• Raportit i punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.• Propozim vendim për bartjen (rialokimi) e buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.
MARS 2020	<ul style="list-style-type: none">• Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2019.• Raportit i punës së tri komiteve konsultative për vitin 2019.• Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2019.• Njoftimit për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hani të Elezit për vitin 2019.
PRILL 2020	<ul style="list-style-type: none">• Raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2020.• Shqyrtimi i raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .• Shqyrtimi i informatës për ndarjen e bursave.• Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për tre mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.

MAJ 2020	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2019. • Shqyrtimi i informatës mbi mbrojtjen e mjedisit. • Miratimi i planit Zhvillimorë Komunal për vitin 2020-2028.
QERSHOR 2020	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza afatmesme buxhetore 2020-2022. • Shqyrtimi i informatës për sektorin e emergjencave. • Shqyrtimi i informatës mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre. • Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2019.
KORRIK 2020	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Prill – Qershor 2020. • Shqyrtimi i informatës mbi raportin e auditorit të përgjithshëm për Komunën për vitin 2019. • Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2019. • Propozim vendimi për themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2021. • Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2020. • Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për gjashtë mujorë e N.P.L “Pastrimi” sh.a.
GUSHT 2020	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2020. • Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-2020. • Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale për vitin 2021. • Shqyrtimi i informatës për korrje shirjet.
SHTATOR 2020	<ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i komunës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2022-2023. • Miratimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale për vitin 2021. • Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2021. • Shqyrtimi i informatës mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.
TETOR 2020	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Korrik – Shtator 2020. • Shqyrtimi i rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2021. • Shqyrtimi i raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Shqyrtimi i informatës së DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2019/2020 në SHFMU dhe SHML. • Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për nëntë mujorë e N.P.L Pastrimi sh.a.
NËNTOR 2020	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi. • Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi. • Miratimi i rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2021.
DHJETOR 2020	<ul style="list-style-type: none"> • Planin e punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2021.

4. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2020, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.
5. Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.
6. Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.
7. Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
8. Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën tre (3) të këtij vendimi , është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.
9. Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2020, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2020.
10. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohet:

Kryetari i Komunës,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe

Shërbimi i Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit

Data: 26.09.2019





01/Nr.8223/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 24, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-48 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkoret Buxhetore 2020/01 me nr. 01/777 dhe 2020/02 me nr.06/1171 për Komunat, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2019 merr:

VENDIMIN

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT 2020 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2021-2022 TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për buxhetin për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2021-2022. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020 është në shumë prej 2,742,095 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2021 janë në shumë prej 2,846,397 € dhe për vitin 2022 janë në shumë prej 2,958,963 €.
2. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2020 sipas pikës (1) të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 2,424,230 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 88.41%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 317,865 € apo 11.59 %.
3. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2020 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe mëditje 1,687,983 €, mallra dhe shërbime 303,236 €, shpenzime komunale 60,000 €, subvencione dhe transfere 61,104 € dhe shpenzime kapitale 629,772 €.
4. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë tabelat e buxhetit për vitet 2020-2022 (tabelat 4.1, 4.2 dhe 4.3).
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave-Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 26. 09. 2019

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

